

Dy të ashtuquajtur “muslimanë tradicionalë” një natë kishin pirë deri vonë dhe i kishte zërë mëngjesi në rrugë. Duke u kthyer në shtëpi, e takuan hoxhën e fshatit i cili po shkonte në xhami për ta falur namazin e sabahut. E përshëndetën atë dhe e lutën që t’ia parashtronin një pyetje. Hoxha duke buzëqeshur iu tha se mund t’i parashtronin edhe dy po të dëshironin. Ata e pyeten: “Kemi dëgjuar se këtu te ne, ekzistojnë disa të rinj që nuk falen sikurse ne (duke aluduar në atë se nuk falen në mënyrën “tradicionale” siç e quajnë ata), a është e vërtetë kjo?” Hoxha iu përgjigj atyre duke buzëqeshur: “Keni plotësisht të drejtë, nuk besoj se ekziston ndokush që falet sikurse ju!”

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

Phoca PDF